

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeministri Rama mbërrin në Berat në turin e takimeve për të diskutuar për reformën territoriale
ADRESA	https://kohajone.com/politike/kryeministri-rama-mberrin-ne-berat-ne-takimet-per-te-diskutuar-per-reformen-teritoriale/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 15:40:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 15:39:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	749ef5d08c5da6526d9d6da0265b96e80bddea83a8e3e2f6558c753760af6ab0
TEKSTI	0728d137969f811a87d097b9e1300a6c7be051b5e16896fe680a2865033a0b31
PAMJA	efaee475b5c5edd94db9da6b00ff1ce4341a3a10592a79cd9600cca9931a18f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	676cc7e42cc2c7720f28a4915742c2bf40ca98e3eab45baa2d21bc87176ff328
E MËPARSHMJA	aa168e064cb08459ad935a1c9902c3135841f194a55064b31fc680050058d6f3
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/676cc7e42cc2c7720f28a4915742c2bf40ca98e3eab45baa2d21bc87176ff328>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Kryeministri Rama mbërrin në Berat në turin e takimeve për të diskutuar për reformën territoriale

[Lajme Politikë](#) E Diel, 13 Shtator 2026 17:39



“Sot në Berat, ku kokëfortësia kolektive e Poliçanit dhe këmbëngulja e disa zonjave të mirëpërgatitura të Dimalit, i dhanë diskutimit shijen e një ballafaqimi të posaçëm” shkruan Rama në publikimin e tij.

 [Koha YouTube Channel](#)

Kryeministri Edi Rama vijoi sot në Berat takimet informuese në kuadër të konsultimit publik për reformën administrative territoriale, duke u ndalur te ndikimi i riorganizimit të njësive vendore në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

Kryeministri theksoi se ky riorganizim nuk cenon ofrimin e shërbimeve në Poliçan, Dimal dhe njësitë e tjera, por synon një administrim më efikas dhe krijimin e mundësive më të mëdha për zhvillim dhe investime në territor.

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Rama deklaroi se bashkimi njësive vendore nuk do të ndikonte në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, duke theksuar se ato do të vijojnë të ofrohen në Poliçan, Dimal dhe në njësitë e tjera të territorit.

“Ma thoni çfarë mendoni ju se do të dëmtohet në rast se do të bëhet bashkimi, kur rruga, shërbimi, këto nuk ndryshojnë. Nuk do të ikë shërbimi nga Poliçani, ose nga Dimali, ose nga askund”, u shpreh Rama.

Sipas kryeministrit, qytetarët do të vijonin t’i merrnin shërbimet pranë vendbanimeve të tyre, ndërsa Poliçani dhe Dimal do të kishin drejtuesit e tyre. Ai shtoi se përfaqësimi i tyre do të garantohej edhe përmes këshilltarëve në këshillin bashkiak të bashkisë së Beratit.

“Nuk ndryshon godina, nuk ndryshon stafi, nuk ndryshon numri i shërbimeve që bëhen, në kuptimin nuk ulet. Në raport me çfarë keni, ndryshon vetëm një gjë: nuk do të keni kryetar bashkie të zgjedhur”, deklaroi Rama.

Kryeministri iu referua edhe reformës territoriale të vitit 2015, duke theksuar se edhe atëherë ishin ngritur shqetësime lidhur me largësinë e shërbimeve dhe ndryshimin e strukturave vendore.

Rama ngriti pyetjen nëse ish-komunat kanë pasur më shumë investime përpara reformës territoriale apo pas përfshirjes së tyre në bashki, duke argumentuar se organizimi aktual ka krijuar mundësi për investime në njësi të ndryshme të territorit.

“Komunat janë më mirë sot apo ishin më mirë kur ishin veç?”, pyeti Rama, duke iu referuar debatit për organizimin territorial dhe nivelin e investimeve në njësitë vendore.

“Më thoni çfarë mendoni ju se do të dëmtohet në rast se do të bëhet bashki. Kur më thua rruga, e më thua shërbimi, këto nuk ndryshojnë. Nuk do të ikën shërbimet nga Poliçani, nga Dimali ose nga askund. Përkundrazi, këto nuk ndryshojnë. Në raport me çfarë keni, ndryshon vetëm një gjë; nuk do të keni kryetar bashkie të zgjedhur. Nuk ndryshon godina, nuk ndryshon stafi, nuk ndryshon numri i shërbimeve që bëhen, në kuptimin nuk ulet, se duhet shtuar. Ti thua distanca? Ça lidhje ka distanca? Ato shërbime që ti merr sot në Poliçan ose në Dimal, do t’i marrësh po aty. Pra, bashki, qytet, njësi administrative. Dhe qyteti Poliçan, qyteti Dimal do të kenë drejtuesin e tyre, do të kenë këshilltarët e tyre në Këshillin Bashkiak të bashkisë Berat, me kuota. Më thoni dhe një gjë tjetër, komunat janë më mirë sot apo ishin më mirë kur ishin veç, se këto biseda unë i kam dëgjuar “mot a mot” në kohën e reformës 2015; “do na ikë kjo, do na ikë ajo; jo distanca; ohu, sa larg është Poliçani, ne jemi këtu te komuna jonë; sa larg është qendra e Urës, ne jemi te komuna jonë; ne kemi këtë, kemi atë, kemi kryetarin e komunës. Ndodhi ndonjë gjë e kësaj natyre? A janë sot, a kanë marrë më shumë investime komunat se ç’bënin më përpara apo kanë marrë më pak? Investimet e komunave nga iu erdhën? Nga vetja? Iu erdhën nga bashkimi”, tha Rama.

Në nisje të takimit në Berat, Rama e cilësoi diskutimin me përfaqësuesit e Poliçanit dhe Dimalit si një ballafaqim të veçantë, duke vlerësuar “kokëfortësinë kolektive të Poliçanit dhe këmbënguljen e disa zonjave të mirëpërgatitura të Dimalit”.

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)


 Logo KOHA JONË SONDAZH

A duhet liruar Erion Veliq të drejtojë bashkinë nga zyra?


☐ Po

☐ Jo

[Më shumë nga Lajme](#)




[EUSACombat Tirana 2026, ministri Gonxhja: 100% e sportistëve janë ako...](#)



[Egla Ceno rrëfen përplasjen me Ramën në takimin për Reformën Territor...](#)




[Premtimi i Trumpit për 5,000 dollarë ‘dividend’ shkakton ...](#)






[Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita: Shkolla ...](#)




[Votohet Qeveria “Kurti 4”, Albin Kurti merr mandatin e ri si kryemini...](#)



[Nufi: Industria e mbrojtjes prioritet strategjik, gjashtë sipërmarrje...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)



[EUSACombat Tirana 2026, ministri Gonxhja: 100% e sportistëve janë akomoduar në kushte optimale](#)

7 minuta më parë





“Pader Gjergj Fishta që ngjet hallkut bishta” – E për njato që keni para, mos ju lutni Zotit hiç

13 minuta më parë



Antonelli triumfon në Spanjë, zhgënjën sërish Hamilton

22 minuta më parë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.